



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 011

KEC

HAP PAS HAPI

Trajnimi avansues për klasën e parë

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve të përgjithshme filozofike* dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si genie intelektuale, sociale dhe emocionale
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*
- Aftësi për *organizimin e mësimit kooperativ* që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm
- Aftësi për *planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimit tematik* me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë*
- Aftësi për *aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies* në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore

- Ide për krijimin e një *ambienti stimulus për mësimnxënie aktive*
- Njohuri për *përfshirjen e familjes* në realizimin e programit

Përmbajtja e trajnimit

Komponentet e një klase me në qendër fëmijën, mësimi aktiv, ndërveprimi në klasë, menaxhimi i klasës: organizimi i materialeve kohës dhe hapësirës, shkrimi dhe leximi I, shkrimi dhe leximi II, mësimi i integruar, komunikimi me fëmijë, planifikimi I, planifikimi II, vlerësimi, matematika.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet mësuesve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimet për shkollë fillore realizohen në kontinuitet për katër vitet akademike në ciklin e ulët të shkollës fillore. Trajnimet mbështesin objektivat e njehta të programit HpH, porse veçojnë karakteristikat e moshës së fëmijëve, si dhe veçantitë e programit të shkollës për nivele të ndryshme. Ato thellojnë njohuritë për problemet e trajtuara në fjalë si dhe zgjerojnë njohuritë për teknika dhe forma të reja të mësimdhënies gjatë procesit mësimor.

Trajnimi avansues për klasën e parë realizohet brenda tri ditëve me gjithsejt 24 orë trajnim dhe pasohet me 4 punëtori njëditore gjatë një viti.

Me qëllim që të përcillet puna në kontinuitet dhe të punohet sa më shumë në cilësi të punës çdo muaj parashihen monitorime në klasë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim.